

BASHKIA TIRANE

Drejtuar: Shoqërisë “Albtelecom” sha
Adresa: Tiranë, Kashar Autostrada Tiranë-Durrës, km 7.

Lënda: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Internet dhe Intranet për Bashkinë e Tiranës dhe për Institucionet e Varësisë”.

Procedura e Prokurimit: Procedurë me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës (në rrugë elektronike) e zhvilluar në mbështetje të ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 33 pika 2/c si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), kreu IV, neni 36, pika 2, gërma (c) si edhe udhëzimit Nr. 02 dt. 08.01.2018 mbi ”Përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Fondi limit: 5.367.169,12 (pesë milion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë presje dymbëdhjetë) lekë pa tvsh, vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të VKB Nr.132, datë 21.12.2017 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për Vitin 2018”.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për përfundim e saj është: Afati i realizimit të shërbimit do të jete konform tabelave 1, 2, 2.1, 3 dhe 4 të percaktuara në pikën 2.5 rubrika ”Vendi i kryerjes së shërbimeve” pjesë perberese e dokumentave standarte të tenderit si dhe referuar dokumentit të specifikimeve teknike bashkelidhur dokumentave të tenderit, me të drejtë ndërprerje menjëherë në rast të lidhjes së një kontrate që do të rezultojë nga procedurat e ndjekura (jo emergjente) në bazë të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 për “Prokurimin publik”, (i ndryshuar).

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në këtë procedurë operatori ekonomik

Shoqëria “Albtelecom” sha NUIS J61824053N

Vlera e Ofertës pa tvsh 5.350.000 (pesë milion e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa T.V.SH.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë “Albtelecom” sh.a me adresë kryesore: Tiranë, Kashar Autostrada Tiranë-Durrës, km 7, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme pa tvsh = 5.350.000 (pesë milion e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa T.V.SH.dhe 6.420.000 (gjashtë milion e katërqind e njëzet mijë) leke me tvsh me afat të realizimit të shërbimit i cili do të jete konform tabelave 1, 2, 2.1, 3 dhe 4 të percaktuara në pikën 2.5 rubrika ”Vendi i kryerjes së shërbimeve” pjese perberese e dokumentave standarte të tenderit si dhe referuar dokumentit të specifikimeve teknike bashkelidhur dokumentave të tenderit, me të drejtë ndërprerje menjëherë në rast të lidhjes së një kontrate që do të rezultojë nga procedurat e ndjekura (jo emergjente) në bazë të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 për “Prokurimin publik”, (i ndryshuar) është ofertë fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, menjehere me marrjen së këtij njoftimi.

